



Me NYC Care mund të merrni kujdes shëndetësor përpara se të sëmureni

Në qytetin e Nju Jorkut, ne besojmë që kujdesi shëndetësor është një e drejtë e njeriut. Pavarësisht se ku keni lindur apo sa para keni, ju keni të drejtë për kujdes shëndetësor cilësor, të përballueshëm në qytetin tonë. **Juve nuk do t'ju duhet më të mbështeteni te dhoma e urgjencës për të marrë kujdesin që ju nevojitet.**

Me NYC Care, ju do të keni ofruesin tuaj të rregullt të kujdesit shëndetësor dhe të merrni shërbimet mjekësore që ju nevojiten në një vend të kujdesit të pacientëve NYC Health + Hospitals në komunitetin tuaj. Gjithashtu, do të mund të merrni kujdesin

parësor, kujdesin obstetrik-gjinekologjik, kujdesin për shëndetin mendor dhe qasje 24/7 në barnat që ju nevojiten.

Me NYC Care, ju do të keni mundësinë të qëndroni të shëndetshëm duke u kujdesur për çdo problem shëndetësor herët gjatë marrëdhënies tuaj me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor. Të gjitha shërbimet ofrohen me pak ose fare pa kosto.

Për
më shumë
informacion dhe
regjistrim telefononi
1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

Privatësia dhe konfidencialiteti janë të garantuara. Regjistrimi në NYC Care nuk përbën rrezik sipas rregullit "akuzë publike".

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Për më shumë informacion
dhe për regjistrim telefononi

1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

nycare.nyc



QËNDRONI TË INFORMUAR. NA NDIQNI.

Gjithë qyteti • Vëllimi 3 • 9/1/20
Albanian 03/22

Çelësi juaj i Kujdesit Shëndetësor të Qytetit

Zhblllokoni të drejtën tuaj për kujdes shëndetësor me dinjitet dhe respekt, pavarësisht nga statusi i imigracionit ose aftësia për të paguar



Në dispozicion
në të gjitha vendet e
NYC Health + Hospitals!
Bëhuni anëtar i NYC Care sot!
1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273
nycare.nyc

Privatësia dhe konfidencialiteti janë të garantuara. Regjistrimi në NYC Care nuk përbën rrezik sipas rregullit "akuzë publike".

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Rreth NYC Care

NYC Care është një program i qasjes në kujdesin shëndetësor që garanton shërbime me pak ose fare pa kosto për njujorkezët që nuk kualifikohen ose nuk mund të përballojnë sigurime shëndetësore. Zhblllokoni të drejtën tuaj për kujdes shëndetësor të përballueshëm me dinjitet dhe respekt, pavarësisht nga statusi juaj i imigracionit ose aftësia për të paguar.

Me NYC Care, mund të:

- + Merrni një kartë anëtarësie për të pasur qasje në shërbimet shëndetësore parësore, parandaluese dhe të specialitetit në vendet e kujdesit të pacientëve NYC Health + Hospitals në komunitetin tuaj.
- + Zgjidhni vetë ofruesin e kujdesit parësor i cili do t'ju ndihmojë të shmangni sëmundjen dhe t'ju lidhë me shërbime të tjera që ju nevojiten për të qëndruar të shëndetshëm.
- + Lini takimin tuaj të parë me ofruesin e kujdesit parësor brenda dy javësh ose më pak. Takimet kryhen përmes telemjekësisë ose personalisht.
- + Kontaktoni Qendrën tonë të Thirrjeve, të disponueshme 24/7, kur keni nevojë për ndihmë.
- + Merrni qasje 24 orë në ditë 7 ditë në javë për ilaçe me receta me kosto të ulët dhe rimbushje brenda natës kur është e nevojshme.
- + Merrni mbështetje nga një ekip i kujdesit parësor që përfshin infermierë, profesionistë të shëndetit mendor, asistentë mjekësorë, punonjës socialë, farmacistë dhe nutricionistë.
- + Mund të përballoni kujdes shëndetësor cilësor. Nuk ka kosto për anëtarësim ose tarifa mujore. Kostoja juaj për të marrë kujdes shëndetësor bazohet në madhësinë dhe të ardhurat e familjes tuaj.

Për më shumë informacion dhe regjistrim telefononi
1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

Privatësia dhe konfidencialiteti janë të garantuara. Regjistrimi në NYC Care nuk përbën rrezik sipas rregullit "akuzë publike".

Shërbimet e Anëtarësisë suaj

Kujdesi parësor dhe parandalues

- + Zgjidhni vetë ofruesin e kujdesit parësor i cili do të trajtojë kushte rutinore fizike, të tilla si mostretja e acideve, dhimbja e fytit dhe ethet, si dhe do t'ju ndihmojë të menaxhoni sëmundjet kronike si diabeti dhe presioni i lartë i gjakut.
- + Merrni vaksinime rutinore dhe vaksinë gripi, mamografi dhe kolonoskopi.

Kujdesi i specializuar

Ofruesi juaj i kujdesit parësor do të punojë bashkë me specialistët dhe do t'ju ndihmojë të referoheni te shërbimet që ju nevojiten, duke përfshirë:

- + Kardiologjia
- + Kujdesi për artritin
- + Ortopedia
- + Podiatria
- + Shërbimet për humbje të peshës
- + Gastroenterologjia
- + Kirurgjia e përgjithshme
- + Kujdesi për veshin, hundën dhe fytin (ENT)
- + Shëndeti i femrave dhe kujdesi prenatal
- + Kujdesi i shikimit

Shëndeti biheviotal dhe përdorimi i substancave

- + Kini qasje në një sërë shërbimesh të shëndetit mendor për të trajtuar depresionin, ankthin dhe kushtet e tjera të shëndetit mendor.
- + Referohuni te specialisti i shëndetit mendor, punonjësi social, terapisti ose psikiatri i duhur.
- + Merrni trajtim e mbështetje për varësinë dhe çrregullimet e përdorimit të substancave.

Barna të përballueshme

- + Merrni ilaçe pa receta me kosto të ulët në farmacitë e NYC Health + Hospitals dhe qasje shtesë në farmaci me orë të zgjatura, duke përfshirë mbrëmjet e ditëve të javës dhe fundjavat.
- + Porositni rimbushjet e recetave në internet.

Për më shumë informacion dhe regjistrim telefononi
1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

Privatësia dhe konfidencialiteti janë të garantuara. Regjistrimi në NYC Care nuk përbën rrezik sipas rregullit "akuzë publike".

Pyetje të shpeshta

Çfarë është NYC Care?

NYC Care është një program me anëtarësim i mundësuar nga NYC Health + Hospitals, që ju lejon të keni qasje te mjeku dhe shërbimet tuaja me pak ose fare pa kosto, përfshirë vizitat te specialistët, barnat dhe qasje në shërbimin e klientëve 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Si të kualifikohem për NYC Care?

Ju duhet të keni jetuar në NYC për gjashtë muaj ose më gjatë dhe të mos keni të drejtë për planet e sigurimit shëndetësor të përballueshëm të qeverisë që janë në dispozicion në shtetin e Nju Jorkut. Ju gjithashtu mund të kualifikoheni nëse nuk jeni në gjendje të përballoni sigurimin shëndetësor bazuar në standardet federale. Për të parë nëse kualifikoheni, telefononi sot 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273).

Sa do të duhet të paguaj për shërbime?

Ju paguani bazuar në çfarë ju mund të përballoni. Tarifat e zbritura përcaktohen nga madhësia dhe të ardhurat e familjes suaj dhe fillojnë nga \$0. Nuk ka tarifa për anëtarësim, tarifa mujore ose tarifa prime. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni **nyccare.nyc** për të parë tabelën tonë të tarifave.

Ku mund të marr shërbime shëndetësore?

Si anëtar i NYC Care, ju do të keni qasje në vendet e kujdesit të pacientëve NYC Health + Hospitals në komunitetin tuaj. Për të gjetur vendndodhjet, vizitoni nyccare.nyc.

A do të mbrohet privatësia ime?

Profesionistët e kujdesit shëndetësor në NYC Health + Hospitals janë të përkushtuar për ta mbajtur privat informacionin tuaj personal shëndetësor dhe statusin tuaj të imigracionit. Kërkoni kujdes pa frikë. Regjistrohuni sot në NYC Care.

Si të mësoj më shumë ose të regjistrohem në NYC Care?

Telefononi 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273). Ju gjithashtu mund të vizitoni **nyccare.nyc** për të mësuar më shumë. Ne flasim gjuhën tuaj!

Për më shumë informacion dhe regjistrim telefononi
1-646-NYC-CARE
1-646-692-2273

Privatësia dhe konfidencialiteti janë të garantuara. Regjistrimi në NYC Care nuk përbën rrezik sipas rregullit "akuzë publike".